



# Përdorimi i kontratave një burimore (të negociuara) në prokurimin publik

2019-2023

## Hyrje

Për të lidhur kontrata publike në Kosovë, autoritetet kontraktuese (AK), përdorin disa procedura të cilat janë përcaktuar në Ligjin për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës (LPP). Gjatë administrimit të cilësdo procedurë, AK-të duhet të sigurohen se janë përmbushur parimet bazë të prokurimit publik, siç janë:

- Konkurrenca në mes të operatorëve ekonomikë (OE);
- Efikasiteti dhe efektiviteti, mos-diskriminimi, objektiviteti; si dhe
- Profesionalizmi dhe llogaridhënia.

Një nga procedurat më të ndjeshme në dhënien e tenderëve është procedura e negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë (tutje: procedura e negociuara). Me këtë procedurë, autoritetet kontraktuese ftojnë një apo disa operatorë që të dorëzojnë oferta ndërkohë tenderimi nuk është i hapur për kompanitë të cilat nuk janë të ftuara. LPP mundëson përdorimin e kësaj procedure, në rastet e emergjencave ekstreme të cilat janë të përcaktuara në nenin 35 të LPP-së<sup>1</sup> ndonëse nuk definohet saktë se çfarë konsiderohet si emergjencë ekstreme, duke lënë hapësirë për interpretime të ndryshme nga ana e AK-ve. Megjithatë, kjo dispozitë nuk mund të shfrytëzohet “nëse rrethanat që e kanë krijuar situatën emergjente ekstreme mund t’u atribuohen veprimeve neglizhente ose të qëllimta ose lëshimeve të autoritetit kontraktues”<sup>2</sup>.

Sipas ligjit, AK-të mund ta përdorin këtë procedurë edhe në situatat, ku për arsye objektive dhe të detyrueshme teknike ose artistike, kontrata duhet t’i jepet një operatori ekonomik të caktuar. Kjo aplikohet në rastet kur bëhet vazhdim i kontratës për shkak të arsyeve të paparashikueshme, brenda shumës 10% të vlerës së kontratës<sup>3</sup>.

<sup>1</sup> Gazeta e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, neni 35, pika 2.

<sup>2</sup> Gazeta e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, neni 35, pika 2.1.iii.

<sup>3</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Rregullore nr.001/2022 për Prokurimin Publik. Neni 13, par. 4.

Nga analizat paraprake dhe raportet vjetore të KRPP-së<sup>4</sup>, rezulton se procedura e negociuar pa publikim të njoftimit të kontratës përdoret edhe në rastet kur nuk kemi të bëjmë me rrethanat e parashikuara në nenin 35 të LPP-së. Për më tepër, kjo procedurë përdoret në vazhdimësi për disa aktivitete specifike si shërbimet për sigurimin fizik të objekteve të institucioneve, transportin e punëtorëve, etj.


Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP), është autoriteti i vetëm i cili mund të jap opinione lidhur me vendimet e autoriteteve kontraktuese për përdorimin e kësaj procedure, por këto opinione nuk janë të detyrueshme.

Autoritetet kontraktuese kanë në diskrecion numrin e operatorëve ekonomikë të ftuar dhe caktimin e afateve kohore për dorëzimin e ofertave, dhe ato detyrohen që ta njoftojnë KRPP-në brenda dy ditëve nga data kur merret vendimi për përdorimin e kësaj procedure, duke ofruar shpjegime të hollësishme të fakteve të konsideruara dhe justifikimin për përdorimin e kësaj procedure.

## Përdorimi i procedurës së negociuar dhe lidhja e kontratave një burimore gjatë viteve 2019-2022


Kontrata të cilat lidhen duke shfrytëzuar procedurën e negociuar njihen si kontrata një burimore. Numri i kontratave një burimore dallon nga viti në vit. Gjatë viteve 2019-2022, numër i lartë i kontratave një burimore është lidhur në vitin 2020 si rezultat i përballjen me pandeminë COVID-19. Numër relativisht i njëjtë i kontratave një burimore është edhe në vitin pasues, edhe pse kriza e pandemisë tashmë kishte kaluar. Rënie lehtë vërehet në vitin 2022, mirëpo krahasuar me vitin 2019, ky numër mbetet sërish i lartë.

**FIGURA 1:** Numri i të gjitha kontratave të nënshkruara dhe numri i kontratave një burimore 2019-2022



<sup>4</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Raporti vjetor 2022, fq. 48. <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Raportet%20Vjetore/shq/Raport%20vjetor%202022.pdf>

**FIGURA 2:** Vlera totale e kontratave të nënshkruara dhe vlera totale e kontratave një burimore 2019 -2022



Të dhënat për vitin 2023 nuk janë përfshirë në këtë tabelë sepse viti 2023 ende nuk ka përfunduar dhe nuk mund të përdoren të dhënat së bashku me vitet e tjera. Megjithatë, nga janari deri në gusht 2023, janë nënshkruar 3,352 kontrata, 63 prej tyre janë zhvilluar me procedurë të negociuar. Vlera e parashikuar që do të shpenzohet për këto kontrata është 567 milionë euro.

Krahas numrit total të kontratave një burimore, në tabelën 1 janë paraqitur institucionet që e kanë përdorur më shumë këtë procedurë gjatë viteve 2019-2023.

Vitet	Numri total i kontratave të nënshkruara nga institucioni	Numri total i kontratave një burimore të nënshkruara nga institucioni	Pjesëmarrja e numrit të kontratave një burimore
2019	Komuna e Prishtinës - 191	Komuna e Prishtinës - 41	21.47%
	Komuna e Ferizajt - 82	Komuna e Ferizajt - 23	28%
2020	Komuna e Prishtinës - 161	Komuna e Prishtinës - 60	37.2%
	Komuna e Gjakovës - 124	Komuna e Gjakovës - 40	32.2%
2021	Komuna e Prishtinës - 152	Komuna e Prishtinës - 38	25%
	Komuna e Gjakovës - 142	Komuna e Gjakovës - 38	26.7%
2022	KEK - 278	KEK - 43	15.4%
	Komuna e Prishtinës - 163	Komuna e Prishtinës - 27	16.5%
2023	KEK - 196	KEK - 24	12.2%
	Komuna e Shtimes - 73	Komuna e Shtimes - 11	15%

**TABELA 1:** Pjesëmarrja e numrit të kontratave një burimore në numrin total të kontratave të nënshkruara në 2019-2023

Sipas tabelës, Komuna e Prishtinës nënshkruan më së shumti kontrata një burimore në çdo vit dhe gjithashtu ka një pjesmarrje të lartë të kontratave një burimore në numrin e përgjithshëm të kontratave.

## Institucionet që lidhin dhe shpenzojnë më së shumti në kontratat një burimore

Në analizën e përdorimit dhe nënshkrimit të kontratave njëburimore për periudhën 2019-2023 është vënë re se disa institucione në vazhdimësi kanë pasur shpenzime më të mëdha për kontrata të tilla. Këto institucione vazhdojnë të nënshkruajnë kontrata njëburimore për të njëjtat raste prokurimi që nuk janë të natyrës emergjente dhe nuk plotësojnë kërkesat ligjore që dalin nga Ligji për Prokurimin Publik, si shërbime për sigurimin fizik të objekteve të institucioneve, transportin e punëtorëve, furnizimin me tekste etj. të shtjelluara në këtë raport.

### Kontrata një burimore në vitin 2019


Në vitin 2019, dy institucionet që lidhën më së shumti kontrata një burimore ishin Komuna e Prishtinës dhe Komuna e Ferizajt.

Komuna e Prishtinës lidhi 42 kontrata një burimore, në vlerë rreth 3,869,641.74 euro, ku pesë prej tyre ishin për punë shtesë, me vlerë prej 106,350.25 euro. Këto kontrata kryesisht u lidhën për shërbime (22 kontrata për shërbime). Si shërbim më i shpeshtë i kontraktuar ishte pastrimi i objektit të komunës dhe shkollave, për të cilat janë lidhur gjashtë kontrata një burimore ndërsa me kontratë janë shpërblyer tre operatorë ekonomikë të njëjtë, apo nga dy kontrata për secilin operator, të cilat kanë arritë vlerën totale rreth 315,835.92 euro. Gjithashtu, janë lidhur katër kontrata për sigurimin fizik, ku kanë fituar kontrata dy operatorë ekonomikë, apo nga dy kontrata për secilin, të cilat kanë arritë vlerën totale rreth 426,830.40 euro.

Këto shërbime të kryera përmes kontratave të negociuara nuk janë të natyrës emergjente dhe nuk plotësojnë asnjë nga rrethanat e parashikuara në nenin 35 të LPP-së. Si rrjedhojë nuk duhej të ishin zhvilluar me procedurë të negociuar.

Sa i përket vlerës së kontratave një burimore, Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit (MKRS) janë dy institucionet që kryesojnë me shpenzimet me të mëdha.

**FIGURA 3:** Autoritetet kontraktuese që shpenzuan shuma më të larta në kontrata një burimore në 2019



MKRS lidhi 10 kontrata të tilla në vlerë totale 13,670,461.92 euro. Ajo çfarë vërehet te këto aktivitete është lidhja e kontratës në vlerë prej 12,394,800.00 euro për renovim dhe rikonfigurim të stadiumit të qytetit të Mitrovicës, dhe kontrata tjetër në vlerë prej 185,000.00 euro për mbikëqyrjen profesionale të renovimit të po këtij stadiumi. Rrjedhimisht, ministria lidhi kontrata një burimore për të njëjtin projekt në vlerë 12,579,800.00 euro.

Në vend të dytë për nga vlera e kontratave me procedurë të negociuar ishte KEK-u, ndërmarrje e cila lidhi 14 kontrata një burimore në vlerë të përgjithshme rreth 11,381,032.00 euro. Përveç punëve shtesë dhe furnizimeve specifike që i nevojiten kësaj ndërmarrje, KEK, me procedurë të negociuar lidhi edhe dy kontrata një burimore për transportin e punëtorëve në vlerën të përgjithshme prej 474,993.78 euro.

## Kontrata një burimore në vitin 2020


Në vitin 2020, institucionet që lidhën më së shumti kontrata një burimore ishin: Komuna e Prishtinës me 60 kontrata në vlerë 3,441,606.79 euro dhe Komuna e Gjakovës po ashtu me 60 kontrata në vlerë 1,417,839.79 euro. Te kontratat e Komunës së Gjakovës, një pjesë e madhe e tyre ishin kontrata për punë shtesë të cilat u janë dhënë operatorëve ekonomikë të njëjtë. Nga 40 kontrata për punë shtesë, nëntë prej tyre janë për të njëjtin grup të operatorëve ekonomikë, ku vetëm për aneks kontrata arrihet vlera 545,069.63 euro.

Institucione tjera që lidhën kontrata një burimore në vlera të larta në vitin 2020 ishin edhe Ministria e Shëndetësisë (MSh) me 8,710,855.78 euro dhe KEK me 7,438,319.67 euro.

KEK ka shpenzuar rreth 7,438,319.67 euro për kontrata një burimore. Nga 27 kontrata të tilla, tri prej tyre kanë të bëjnë me informimin e publikut për punën dhe obligimet e KEK-ut. Në këto tri kontrata janë shpenzuar 161.586.00 euro dhe është një aktivitet që nuk është bërë para vitit 2020 dhe as

në vitet në vijim. Është e paqartë pse janë hapur tre tenderë me procedurë të negociuar dhe me kohëzgjatje prej 12 muajsh për aktivitete të ngjashme, kur do të mjaftonte përdorimi i procedurës së hapur për këto aktivitete dhe zhvillimi i vetëm një aktiviteti.

**FIGURA 4:** Autoritetet kontraktuese që shpenzuan shuma më të larta në kontrata një burimore në 2020



MSh ndërkohë shpenzoi 9,863,372.32 euro në kontrata një burimore. Kryesisht këto kontrata kanë pas për qëllim furnizimin me materiale, vaksina dhe medikamente për mbrojtjen ndaj virusit të COVID-19.

Nënshkrimi i këtyre kontratave në vitin 2020 u detyrua nga pandemia COVID-19 dhe nevoja urgjente për furnizimin me materialet e nevojshme për qytetarët dhe personelin mjekësor. Përdorimi i kësaj procedure ishte nevojshëm. Megjithatë, procedura për aktivitete jo emergjente u karakterizua edhe nga disa parregullsi, si planifikimi i dobët, mungesa e hulumtimit të çmimeve të tregut, mungesa e sqarimeve shtesë për çmimet e ulëta të produkteve, pranimi i dokumenteve të skaduar, pranimi i mallrave që nuk përputhen me specifikimet teknike në dosjen e tenderit<sup>5</sup>, njoftimi për ofertim i vetëm një operator ekonomik, përcaktim i komunës se kompanitë duhet të konkurrojnë si konsorcium<sup>6</sup>.

<sup>5</sup> COVID-19 si pretekst për lidhjen emergjente të kontratave II, tetor 2021. [https://dplus.org/wp-content/uploads/2021/12/SHO\\_COVID-19-si-pretekst-per-lidhje-emergjente-te-kontratave-ne-prokurim-publik-II.pdf](https://dplus.org/wp-content/uploads/2021/12/SHO_COVID-19-si-pretekst-per-lidhje-emergjente-te-kontratave-ne-prokurim-publik-II.pdf)


<sup>6</sup> COVID-19 si pretekst për lidhjen emergjente të kontratave, qershor 2021. [https://dplus.org/wp-content/uploads/2021/06/SHO\\_COVID-19-si-pretekst-per-lidhje-emergjente-te-kontratave-ne-prokurim-publik-I.pdf](https://dplus.org/wp-content/uploads/2021/06/SHO_COVID-19-si-pretekst-per-lidhje-emergjente-te-kontratave-ne-prokurim-publik-I.pdf)

## Kontratat një burimore në vitin 2021

Gjatë vitit 2021 është ulur numri i kontratave një burimore dhe shpenzimet për këto kontrata. Në këtë vit, në kontrata të tilla më së shumti shpenzuan KEK, Ministria e Infrastrukturës dhe Ministria e Punëve të Brendshme (MPB), dhe Komuna e Gjilanit.

Në vitin 2021, Komuna e Gjilanit ka dhënë 16 kontrata një burimore, duke shpenzuar gjithsej 1,331,680.69 euro, pjesa më e madhe është për krijimin e rrugëve dhe qendrave publike. Në të shumtën e rasteve, të njëjtit operatorë ekonomikë janë shpërblyer me këto kontrata, me katër kontrata në vlerë prej 171,697.68 euro është shpërblyer i njëjti operator ekonomik, dhe tre kontrata për një operator tjetër ekonomik në vlerë prej 820,480.96 euro. KEK ka nënshkruar kontrata një burimore në vlerë prej rreth 5,730,932.28 euro.

**FIGURA 5:** Autoritetet kontraktuese që shpenzuan shuma më të larta në kontrata një burimore në 2021




Po ashtu, Komuna e Prishtinës shpenzoi rreth 2,089,391.80 euro në kontrata një burimore. Ajo çfarë bje në sy nga këto kontrata një burimore është se janë lidhur për sigurimin fizik të objektit të komunës dhe institucioneve tjera. Këto kontrata u lidhën vetëm me dy operatorë ekonomikë në vlerë të përgjithshme 746,649.77 euro. Kontrata të lëndës së njëjtë dhe me po të njëjtit operatorë ekonomikë, Komuna e Prishtinës ka lidhur edhe në vitet 2020 dhe 2019.

## Kontrata një burimore në vitin 2022

Institucionet e njëjta del të kenë lidhur më së shumti kontrata një burimore. Komuna e Prishtinës dhe KEK-u kanë numrin më të madh të kontratave të tilla. KEK, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit kanë shpenzuar një shumë të konsiderueshme për kontratat një burimore në vitin 2022.

Në vitin 2022, KEK ka shpenzuar rreth 27,406,550.38 euro për kontrata të tilla. Vlen të theksohet se për të njëjtat raste është përdorur procedura e negociuar. Për shembull: për sigurimin fizik të objektit të KEK-it, me të njëjtin operator ekonomik janë lidhur katër kontrata një burimore, në vlerë të përgjithshme prej 2,185,665.96 euro. Po ashtu, janë lidhur katër kontrata një burimore për transportin e punëtorëve të KEK-it me operatorët e njëjtë ekonomik. Devijime nga vlera e parashikuar janë vërejtur edhe në këto kontrata të KEK-it, me tetë kontrata të lidhura me çmim më të lartë se sa vlera që ishte planifikuar të shpenzohej.

**FIGURA 6:** Autoritetet kontraktuese që shpenzuan shuma më të larta në kontrata një burimore në 2022



MKRS-ja ka përdorur procedurën e negociuar kryesisht për punë shtesë, por edhe për prokurime të tjera. Kostoja e 18 kontratave një burimore ishte afërsisht 1,857,914.89 euro. Për shembull, është nënshkruar një kontratë një burimore për të bërë ndërhyrje në Pallatin e Rinisë në Prishtinë, ku në dosje të tenderit nuk është dhënë ndonjë sqarim që dëshmon urgjencën e këtij aktiviteti. Të njëjtit operator i është dhënë kontrata për ndërhyrje në ish-burgun e Prishtinës, ku edhe në këtë rast nuk ka pasur sqarime që mbështesin përdorimin e procedurës së negociuar. Vlera e këtyre dy kontratave së bashku është 37,283.95 euro.

## Kontratat një burimore në gjashtë mujorin e parë të vitit 2023

Në gjashtë mujorin e parë të vitit 2023, KEK-u ka vazhduar të jetë lider në lidhjen e kontratave një burimore. Përveç KEK-ut, Komuna e Prishtinës dhe Komuna e Shtimes kanë pasur një numër të madh të kontratave një burimore, ndonëse kjo e fundit ka lidhur kontrata në vlera të ulëta.

Komuna e Prishtinës në 10 kontrata një burimore ka shpenzuar 2,275,825.36 euro. Kontrata me vlerë më të lartë është lidhur me O.U.D. Architects dhe Kengo Kuma and Associates, në vlerë prej 1,600,000.00 euro, për të hartuar projektin për qendrën multifunkionale "Gërmia" në Prishtinë. Komuna e Prishtinës ka lidhur përsëri kontratë një burimore për sigurimin e objekteve të komunës, por kësaj radhe me një operator ekonomik tjetër.

Ndërkohë, KEK-u vetëm në gjashtë mujorin e parë të vitit 2023 ka lidhur kontrata një burimore në vlerë prej 67,423,530.77 euro. Sikurse në vitet paraprake, edhe këtë vit kontratat një burimore kryesisht janë lidhur me operatorët e njëjtë ekonomikë për lëndë të njëjta. Gjithashtu, edhe në këtë gjashtë mujorë, KEK-u ka raste kur ka tejkalluar vlerën e parashikuar. Kontrata me vlerën më të lartë lidhur për modernizimin e turbinave B1 dhe B2, e cila kishte vlerën e parashikuar prej 55,100,000.00 euro, ndërsa kontrata është lidhur në vlerën prej 56,522,100.00 euro, apo 1,422,000.00 më e lartë se vlera e parashikuar.



## Roli i KRPP-së në monitorimin dhe kufizim e përdorimit të kontratave një burimore

Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik (KRPP) ofron opinione për autoritetet kontraktuese në lidhje me vendimet e tyre, veprat apo anashkalimet gjatë një aktiviteti të prokurimit. Në kuadër të kësaj kompetence, në rastet kur autoritetet kontraktuese për një aktivitet të prokurimit vendosin që të përdorin kontratat një burimore, ato duhet që të njoftojnë KRPP-në brenda dy ditëve pas marrjes së vendimit për përdorimin e kësaj procedure, duke ofruar shpjegime të hollësishme të fakteve të konsideruara dhe justifikimin për përdorimin e kësaj procedure<sup>7</sup>. Nga monitorimi i prokurimit publik dhe analizimi i kontratave një burimore, rezulton se AK-të nuk japin shpjegime të mjaftueshme të bazuara në fakte që do të arsyetonin përdorimin e kësaj procedure në njoftimet e tyre drejtuar KRPP-së. Sipas një mostre të lëndëve të marra, vërehet se shpjegimet nuk janë të detajuara dhe të mjaftueshme.

KRPP nuk arrin t'i trajtojë të gjitha njoftimet e AK-ve, brenda dy ditëve, për shkak të kapaciteteve të kufizuara njerëzore<sup>8</sup>, me AK-të që në shumicën e rasteve e marrin heshtjen si aprovim duke vazhduar me lidhjen e kontratave një burimore. Gjatë vitit 2022, KRPP ka monitoruar 319 procedura/kontrata të tilla<sup>9</sup>, ndërsa nuk ka të dhëna të raportuara për rezultatin e këtyre monitorimeve. Cilado qoftë përgjigja e KRPP-së lidhur me vendimin e marrë nga AK-të, ajo nuk është detyruese. Kjo do të thotë se edhe kur KRPP-ja nuk e miraton përdorimin e kësaj procedure, vendimi përfundimtar mbetet në diskrecionin e Autoritetit Kontraktues.

Përdorimi i gjerë i kontratave një burimore për aktivitetet që nuk janë urgjente ndër vite, tregon se ky fenomen po vazhdon përkundër rolit nominal të KRPP-së në mbikëqyrjen e tij. Në këtë mënyrë, roli mbikëqyrës i KRPP-së, përkatësisht opinioneve që lëshohen për këtë procedurë mbetet i zbehtë për faktin se nuk kanë karakter detyrues për autoritetet kontraktuese.

<sup>7</sup> Gazeta e Republikës së Kosovës. Ligji nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, neni 35, pika 1. <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772> (qasur për herë të fundit 11.07.2023).

<sup>8</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Raporti Vjetor 2022, fq. 49. <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Raportet%20Vjetore/shq/Raporti%20vjetor%202022.pdf>

<sup>9</sup> Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik. Raporti Vjetor 2022, fq. 27. <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Raportet%20Vjetore/shq/Raporti%20vjetor%202022.pdf>

## REKOMANDIME

1. Gjatë hartimit të Ligjit të ri për prokurim publik, të rregullohet gjerësisht çështja se kur mund të përdoret procedura e negociuar nga AK-të. Ligji duhet të kategorizojë emergjencat ekstreme në kuadër të të cilave AK-të mund të gjejnë arsytimin për përdorimin e kontratave një burimore;
2. KRPP duhet të bëjë rishikime shpesh të legjislacionit dytësor të prokurimit publik për të kufizuar zbatimin e procedurës së negociuar duke bërë të detyrueshme për autoritetet kontraktuese që të publikojnë njoftimin për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë në e- platforma e prokurimit. Njoftimi duhet të përfshijë sqarime dhe bazën ligjore në mënyrë që palët e interesuara të informohen dhe të kenë mundësi apelimi në OSHP;
3. Autoriteteve kontraktuese duhet t'u mundësohet publikimi i njoftimit për përdorimin e procedurës së negociuar pa publikim të njoftimit për kontratë në platformën e prokurimit elektronik;
4. Të rriten kapacitetet njerëzore të KRPP-së, në mënyrë që të trajtohen të gjitha njoftimet e autoriteteve kontraktuese për përdorimin e kësaj procedure dhe në të njëjtën kohë të theksohet se heshtja e KRPP-së nuk nënkupton aprovim për përdorimin e kësaj procedure;
5. Autoritetet kontraktuese të ofrojnë shpjegime shteruese të bazuara në fakte të cilat justifikojnë përdorimin e kësaj procedure në njoftimet për KRPP-në, në mënyrë që të lehtësojnë vlerësimin dhe dhënien e opinionit nga ky organ;
6. KRPP të ofroj trajnime për zyrtarët e prokurimit, në mënyrë që të rrisë aftësitë e interpretimit dhe përdorimit të drejtë të dispozitave që rregullojnë përdorimin e kësaj procedure;
7. KRPP të shtoj bashkëpunimin me OSHP-në dhe autoritetet kontraktuese, dhe të marrë masa disiplinore ndaj zyrtarëve të cilët në mënyrë të përsëritur përdorin këtë procedure kundërligjshëm.

